



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.255/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Skender Çoçaj kryesues, Kymete Kicaj dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 01.02.2025, merr këtë,

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa Anr.255/2025 e datës 29.01.2025, e parashtruar nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025.

A r s y e t i m

Me datë 29.01.2025, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik, Lëvizja Vetëvendosje, (LVV), me të cilën pretendon se më 29 janar 2025, Qendra e Lëvizjes Vetëvendosje në Fushë Kosovë, ka identifikuar banerin/posterin e vendosur në hapësirat/rrugët publike të kandidatit për deputet të PDK-së, Xhevahir Geci, në rrugën publike “Dardania”, në Fushë Kosovë, ky baner/poster është vendosur në oborrin e SHFMU “Mihal Grameno” në Fushë Kosovë, ku me këtë veprim kandidati dhe subjekti politik PDK kanë bërë shkelje të nenit 34, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës-LZP. Më tutje parashtruesi i ankesës ka theksuar se përmes këtij veprimi subjekti përkatës, ka cenuar rëndë dispozitat përkatëse ligjore, andaj duke u mbështetur në bazën ligjore dhe argumentet e lartcekura, gjithashtu bazuar tashmë në praktikën e PZAP-së, mes tjerash me vendimet A.nr.48/2025, A.nr.49/2025, A.nr.50/2025, A.nr.51/2025, ka kërkuar që masa e sanksionit të vendoset në përputhje me legjislacionin në fuqi. Si provë ka bashkangjitur një foto që dëshmon vendosjen e banerëve/posterëve në kundërshtim me LZP.

Më datë 30.01.2025, PZAP-i, e njoftoi Subjektin Politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje deri me datë 31.01.2025 në ora 09:00.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur më datë 31.01.2025, subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), ka theksuar se e njofton PZAP-in se adresa të cilës i referohet ankuesi në ankesë Rr.“Dardania”, në fakt zyrtarisht kjo rrugë është e emëruar si Rr.“Nëna Tereza”, gjithashtu pretendimi që baneri i vendosur është në oborrin e SHFMU “Mihal Grameno” është i paqëndrueshëm, për faktin se siç do t’ a vërej PZAP në provën e bashkangjitur e njëjta është në afërsi të shkollës, mirëpo asesi në “oborrin” e SHFMU “Mihal Grameno” siç gabimisht pretendohet nga ankuesi. Më tutje në përgjigje në ankesë është theksuar se PDK në lidhje me këto pretendime, njofton PZAP-in se PDK-Dega në Fushë Kosovë, me datë përmes shkresës nr.prot.43, të datës 22 janar 2025, ka marrë pëlqimin nga Drejtoria për Shërbime Publike dhe Mjedis në Komunën e Fushë Kosovës për shfrytëzimin e panos reklamuese afër SHFMU “Mihal Grameno”, në adresën Rr.“Nëna Tereza”, në Fushë Kosovë, si dhe përmes përgjigjes në ankesë ka propozuar që të refuzohet si e pabazuar ankesa e parashtruar nga subjekti politik LVV dhe të konstatohet se veprimet e ankimuara nuk përbëjnë shkelje të nenit 34, par.1 nën par.1.2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

- Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga Subjekti Politik PDK, vlerësoj se pretendimet e Subjektit Politik LVV, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku parashihet se *“Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose ndryshe që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronareve ose shfrytëzuesve.”*

Andaj Paneli ka gjetur se në bazë të shkresave të bashkangjitura në përgjigje në ankesë në këtë rast, në bazë të Pëlqimit të lëshuar nga Drejtoria për Shërbime Publike dhe Mjedis të Komunës së Fushë Kosovës, mbi shfrytëzimin e panos reklamuese afër shkollës “Mihal Grameno”, me adresë rr.“Nëna Tereza”, Fushë Kosovë për vendosjen e posterit në hapësirat/rrugët publike", vërtetoi se vendosja e posterit nga kandidati për deputet nga radhët e Subjekti Politik PDK, është në pajtim me nenin 5 të Rregullores Zgjedhore Nr.07/2024, neni 5 Të drejtat dhe obligimet e subjekteve politike gjatë mbajtjes së tubimeve publike konkretisht nën paragrafi 1.2 *“të publikojnë dhe të shpërndajnë afishe përmes*

shtandeve apo ne hapësira publike, reklama dhe material tjetër lidhur me një fushate zgjedhore”.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se “vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nga parashtruesi i ankesës nuk paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën e refuzoi si të pabazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.255/2025, datë 01.02.2025

Kryesuesë e Panelit
Skender Çoçaj



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.